

V E N D I M

Nr.38, datë 25.1.1999

PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCESION TË SH.A. “SUPERFOSFATIT” KURBIN

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shoqëria anonime “Superfosfati” Kurbin t’i jepet në konçension kompanisë franceze “EVERTRADE” s.a. sipas projektit të pakërkuar, propozuar nga kjo kompani.
 2. Forma e kontratës koncesionare të jetë R.O.O. (Rehabilitim, Pronësi, Shfrytëzim).
 3. Organi i autorizuar shtetëror për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate të jetë Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
 4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e procedurave të privatizimit apo të likuidimit të kësaj ndërmarrjeje në rast të mosrealizimit të kësaj kontrate.
 5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko